



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.04.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.Sh."Korben", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Sallës së Ed.Fizike në shkollën Kadri Kusari-Gjakovë -faza-II-të", me Nr. të Prok: 632-21-721-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik N.N.Sh."Korben" e dt.12.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Sallës së Ed.Fizike në shkollën Kadri Kusari-Gjakovë -faza-II-të", me Nr. të Prok: 632-21-721-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 06.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Anulohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: 06.04.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit të ktheje ne Rivlersim .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Meqë Operatori Ekonomik N.N.Sh."Korben, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Sallës së Ed.Fizike në shkollën Kadri Kusari-Gjakovë -faza-II-të", me Nr. të Prok: 632-21-721-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1.Për pretendimin tuaj se:

“OE i përzgjedhur nga AK Ing të Arkitekturës ia ka prezentuar kontratën mbi vepër e cila siq kërkohet në DT nuk kishte të cekur titullin e projektit siç është kërkuar në DT. me ç’rast nuk është respektuar neni 69 i LPP. Dhe kështu ishte dashur të hudhet posht ai arkitekt. Pasi që në DT është kërkuar kuart, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë.”,

Pas rishikimit të dokumenteve Autoriteti kontraktues sqaron se: për inxhinjeren e arkitekturës Znj. Lumturije Ahmeti, tashme është kontrata e nënshkruar nga te dy palët për detyra specifike për angazhimin e saj jo me gjate se 120 dite brenda një viti kalendarik dhe se ajo është edhe në listën e pagave si punëtore sekondare, prandaj ky pretendim i juaj është i pabazuar :

**KONTRATË PUNE
PËR PUNË DHE DETYRA SPECIFIKE**

Neni 1

Me këtë Kontratë:

1. Punëdhënësi: NNSH EMSA-Suhareke Rr.Brigada 123 pn-811042811
(emri, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit të Punëdhënësit)

të cilin e përfaqëson: Hysen Sopa (në tekstin pasues: Punëdhënësi)

dhe

2. Punëmarrësi: Lumturije Ahmeti me nr.personal 100358364 , Ing.Dipl.Arch-Pejë
(emri e mbiemri, kualifikimi, dhe adresa e Punëmarrësit)

përcaktojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për krijimin e marrëdhënieve kontraktuale të punës.

Neni 2

Punëdhënësi i ofron, ndërsa punëmarrësi pranon të lidhë kontratë pune për një detyrë specifike e cila nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzetë (120) ditë brenda një viti kalendarik.



Lista e Punëtorëve

Periudha 2021

Numri Fiskal	811042811	Kontakti	HYSEN-SOPA
Tatimpaguesi	Hysen Sopa B.I.	Adresa	BRIGADA 123
Regjioni	PRIZREN 1	Tel	049/770083 049/770083 049/770083
Lloji	Individual	Aktiviteti	Instalime elektrike

Nr.	Emri	Nr. Personal	Primare	MUAJT											
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	BASHKIM VESELAJ	1003424649	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	FATBARDHA SOPA	1171894138	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	HASAN	1170137031	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	IRFAN SHALA	2002498327	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	JETON BIQJA	1233994428	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	JETON KARAXHA	1002909096	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	LEOTRIM BEHLULI	1243132327	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8	LUMTURIJE AHMETI	1003583336	JO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
9	MARTIR DEMIRE	1172401887	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	MUHAMET SOPA	1007969364	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
11	PETRIT DEMIRAJ	2171852407	JO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12	SYTRIM BARALIU	1244009723	PO	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

2/19/2021 8:59:35 AM

2.Pretendimi juaj se:

" Gjithëashtu duke u bazuar edhe në shkresën të datës 02.03.2021 njëri ndër kriteret nuk është vetëm çmimi më i ulët por në përputhje me nenin 13 të Ligjit për rimëkëmbje, Ligji nr. 07/L-016 qka nënkuptojmë së është e preferueshme të ofertohej me produkte vendore vetëm në rast se çmimi nuk është më i lartë se 15%."

Autoriteti kontraktues sqaron se: Pretendimi juaj është i pa bazuar sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar në dosje të tenderit;

Nënkontraktimet	12.1	a) një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe
-----------------	------	---

		b) Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.
Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> <i>Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:</i> Tenderuesi duhet të depozitohet sigurimin e tenderit.
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë apo muaj
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është <i>[shëno shumën apo përqindjen në fjalë dhe figura]</i> apo 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 60 ditë për kohëzgjatjen e periudhës prej <i>[shëno kohëzgjatjen në ditë apo muaj]</i> .
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	08.03.2021
Dokumentet që përbejnë Tenderin	19.1(h)	Operatorët Ekonomik me rastin e aplikimit qoftë individualisht ose si Grup I Operatorëve Ekonomik duhen të jenë të regjistruar në Platformën elektronike të prokurimit.
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 60 ditë.
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je 17.03.2021 13:30:00 Vendi: Në platformën e sistemit të e-prokurimit.
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do të bëhet me 17.03.2021 13:30:00 Vendi: Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët; <input checked="" type="checkbox"/>
Ankesat	31.3	Adresa elektronike ku mund të dërgohen ankesat është platforma elektronike e prokurimit https://e-prokurimi.rks-gov.net/

3.Pretendimi juaj se Operatori Ekonomik i përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktues ka çmim jo-normalisht të ulët, është i bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës